

KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr. 4: Tiranë



ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Bulevardi "Zhan d'Ark", nr. 11, Tiranë. Email: pd@rithemelimi.com
PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË (PD)	

09 15:00

OBJEKTI I ANKIMIT

- Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 179, datë 18.03.2023; dhe
- Ndryshimin e këtij vendimi, duke vendosur: Pezullimin e regjistrimit të subjektit "Partia Demokratike" me nënkryetar z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimin e subjektit "Partia Demokratike e Shqipërisë" e përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha.

Vendimi	<u>TITULLI I VENDIMIT</u> <i>"Për shqyrtimin e kërkesës së "Partisë Demokratike" për regjistrimin si Subjekt Zgjedhor për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të Datës 14 Maj 2023"</i>
Nr.	Datë
<u>179</u>	18/03/2023

- Regjistrimin e subjektit "Partia Demokratike" me nënkryetarin z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 14 majit 2023.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

BAZA LIGJORE:

Neni 4, pika 1 e Kushtetutës së Shqipërisë; Nenet: 3, 8, 10, 12, 13, 19, neni 21, 26, nenet 63, 64, Neni 124 e vijues, si dhe nenet 136, 139, 140, 141 e vijues të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.



PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, në datë 05.03.2023, ka paraqitur pranë KQZ dokumentacionin e plotë administrativ dhe ligjor për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, kërkesë e regjistruar në KQZ me nr. Prot. 1329.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi mori në shqyrtim kërkesat me nr. 1329 Prot., datë 5.3.2023 dhe kërkesë me nr. 1337 Prot., datë 06.03.2023, me Kërkues: 1) Z. Indrit Sefa, në cilësinë e përfaqësuesit të z. Lulëzim Basha si kryetar i "Partisë Demokratike" dhe 2) Z. Sali Berisha, përfaqësuar nga Z. Ledio Nuraj dhe Z. Franci Nuri, me objekt: **Regjistrimi i "Partisë Demokratike"/ "Partisë Demokratike të Shqipërisë" si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023**, pasi i bashkoi dy kërkesat në një çështje të vetme, në seancën publike të datës 9 Mars 2023, **me Vendimin Nr. 158, ka vendosur:**

- 1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, "Partisë Demokratike" sipas arsytimit të këtij vendimi.***
- 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.***
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij".***

Në datë 11 Mars 2023, Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar Sali Berishën j'u drejtua KAS-it për të kundërshtuar atë vendim të padrejtë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me kërkesën ankimore nr. 29. Pas shqyrtimit të çështjes në seancë paraprake në datë 13.03.2023, KAS-i vendosi: ***"mos kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 29, të depozituar nga Partia Demokratike, përfaqësuar nga z. Sali Berisha"***. Nga shpjegimet e arsytimit të vendimit të tij në seancë, KAS shpjegoi se për sa kohë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ishte shprehur ende me vendim përfundimtar, nëse do të pranonte apo jo regjistrimin e PD si subjekt zgjedhor, atëherë vendimi nr. 158 i KSHZ konsiderohej vendim i ndërmjetëm, ndaj të cilit sipas KAS nuk lejohet ankim.

Në datë 14.03.2023, KSHZ vijoi shqyrtimin e çështjes së regjistrimit të Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor dhe në përfundim, pasi dëgjoi përfaqësuesit e palëve, **Komisioneri Celibashi, me vendimin nr. 172, datë 14.03.2023 vendosi:**

- 1. Të mos regjistroj "Partinë Demokratike" me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat instore "PD" ose "PDSH" si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.**
- 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.**
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.**

Ndaj këtij vendimi të KSHZ paraqiti ankimim në datë 14.03.2023 përfaqësuesi i z. Basha, **ndërsa në datë 15.03.2023**, Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar Sali Berishën e kundërshtoi në KAS vendimin nr. 172, datë 14.03.2023 të KSHZ si një vendim antikushtetues dhe antiligjor. Në datë 15.03.2023, me vendimet e tij nr. 24 dhe nr. 25, pasi shqyrtoi çështjet në seancë KAS vendosi të kalojë në shqyrtim themeli dy ankimimet e paraqitura, si dhe me vendimin nr. 26 KAS vendosi t'i bashkojë ato në një çështje të vetme me të njëjtin relator.

Në datë 16.03.2023, me vendimin nr. 27 i marrë me shumicë votash 4 me 1, KAS në një vendimmarrje të paprecedentë, në shkëlqje të Kushtetutës, Ligjit për Partitë Politike si dhe Kodit Zgjedhor, duke uzurpuar kompetencën e gjykatave të vendit si dhe në tejkalim të çdo kompetence administrative dhe ligjore, vendosi :

- “1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 33 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri;
2. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore nr. 32 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa;
3. Ankuesi “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa të depozitohet në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë:
 - deklaratën sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
 - “deklaratën e angazhimit solemn” të nënshkruar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
4. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor “Partia Demokratike” me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.”.

Pas kësaj vendimmarrjeje nëpërmjet të cilës KAS “njohu” si kryetar të PD nënkryetarin e pretenduar të komanduar (por pa asnjë provë të tillë të depozituar në KQZ nga vetë kërkuesi), si dhe pas plotësimit të shkresave formale nga përfaqësuesi me autorizim i Lulzim Bashës, KSHZ caktoi datën 18.03.2023 për shqyrtimin e regjistrimit të PD me nënkryetar z. Enkelejd Alibeaj, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në seancën publike të datës 18.03.2023 z. Franci Nuri, në cilësinë e përfaqësuesit të Partisë Demokratike me Kryetar Sali Berishën, i kërkoi zyrtarisht Komisionerit Ilirjan Celibashi të pezullonte regjistrimin e Partisë Demokratike me kryetar nënkryetarin Alibeaj, për sa kohë që:

- (i) afati i ankimit ndaj vendimit të KAS nuk kishte kaluar;
- (ii) pala e cënuar ishte duke përgatitur ankimin në Kolegjin Zgjedhor ; si dhe
- (iii) zbatimi i një vendimi të KAS pa pritur vendimmarrjen e Kolegjit, do të cënonte rëndë garancitë kushtetuese dhe ligjore për një proces të rregullt ligjor dhe për të drejtën e një mbrojtje efektive të palës ankuese.

Fatkeqësisht Komisioneri Celibashi nuk i mori në konsideratë këto fakte dhe argumenta, duke vijuar me zbatimin e vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS, si dhe duke regjistruar formalisht Partinë Demokratike me kryetar, nënkryetarin në cilësinë e kryetarit, të komanduar ;

Në datë 20.03.2023 u depozitua në Kolegjin Zgjedhor ankimi ndaj vendimit të KAS nr. 27, datë 16.03.2023, nga Partia Demokratike e përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Të gjitha faktet, indiciet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se vendimi i Komisionerit objekt ankimi ka ardhur në kundërshtim me kuadrin ligjor.

Kodi Zgjedhor, në Nenin 158 “Llojet e vendimeve të Kolegjit Zgjedhor”, parashikon se:

- “1. Në varësi nga çështjet në shqyrtim, Kolegji Zgjedhor vendos:
 - a) pushimin e gjykimit;
 - b) gjykimin e çështjes në themel; ose



Seni
Nënshkrimi i Ankuesit

c) detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim.

2. Pushimi i gjykimit vendoset kur Kolegji Zgjedhor konstaton se ankimi është paraqitur jashtë afateve të përcaktuara në këtë Kod ose për mungesë kompetence. Kur Kolegji Zgjedhor vendos mungesën e kompetencës, ia dërgon çështjen organit kompetent.

3. Me gjykimin e çështjes në themel, Kolegji Zgjedhor vendos pranimin e plotë apo të pjesshëm të padisë ose rrëzimin e plotë apo të pjesshëm të saj.

4. Kolegji Zgjedhor vendos detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim, në zbatim të pikës 2 të nenit 145 të këtij Kodi. Në këtë rast Kolegji Zgjedhor cakton afat të prerë për marrjen e vendimit jo më të gjatë se 10 ditë.

5. Vendimi i Kolegjit Zgjedhor është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim.

6. Kolegji Zgjedhor është i detyruar të zbardhë vendimin jo më vonë se tre ditë nga data e dhënies së tij”.

Në kushtet kur Kolegji Zgjedhor do të shprehet brenda afateve të caktuara nga ligji për ankimin e sipërcituar, si dhe për sa kohë Kolegji mund të vendosë potencialisht të pranojë padinë dhe të prishë vendimin e KAS, gjykojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kishte detyrimin që të pezullonte zbatimin e vendimit nr. 27 objekt ankimi në Kolegji, derisa Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar.

Kodi Zgjedhor në tërësinë e tij, por as në veçanti Neni 21 i Kodit Zgjedhor, (dispozitë kjo e cila trajton kompetencat e KAS), nuk parashikon në asnjë moment se vendimmarrjet e KAS të jenë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme menjëherë.

Përkundrazi, Neni 158 i Kodit Zgjedhor që trajton llojet e vendimmarrjeve të Kolegjit Zgjedhor, parashikon se vendimi i Kolegjit “është i formës së prerë. Ndaj tij nuk bëhet ankim”, çka nënkupton se a contratio, se vendimet e KAS nuk janë të formës së prerë.

Rrjedhimisht, nga arsyetimi i vendimit të KSHZ në seancën publike të datës 18.03.2023 nuk shohim asnjë arsye përse nuk duhej pritur vendimi i Kolegjit Zgjedhor për këtë çështje. Kjo praktikë, është e bazuar në ligj si dhe në precedentët e mëparshëm të gjykuar nga vetë Kolegji Zgjedhor në të shkuarën.

Nëse pranojmë si normal qëndrimin e KSHZ në rastin konkret, i cili ka zbatuar një vendim të KAS pa pritur ende fjalën e fundit të Kolegjit Zgjedhor, me të drejtë mund të shtrojmë pyetjet:

Cfarë ndodh nëse Kolegji vendos në favor të ankimi të PD të përfaqësuar nga Sali Berisha? Në atë rast, Komisioneri do detyrohet të ç’regjistrojë PD të nënkryetarit Alibeaj.

Prandaj, për të mos paragjykuar besueshmërinë e procesit zgjedhor, të gjitha palët duhet të kishin pritur me qetësi vendimmarrjen e Kolegjit Zgjedhor, përpara se të planifikonin seancën për regjistrimin e PD në zgjedhje. Për më tepër kur dihet se KAS prishi vendimin nr. 172 të vetë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i cili, kishte vendosur të mos regjistronte asnjë subjekt, gjykojmë se edhe Komisioneri kishte interes të ligjshëm të priste vendimmarrjen e Kolegjit për të parë si do të trajtohej kjo problematikë.

Edhe argumentat e përdorur në seancë nga përfaqësuesi me autorizimin e Lulzim Bashës, se vendimi i KAS duhej zbatuar menjëherë thjesht dhe vetëm se vendimi i KAS në dispozitiv shkruan formulën standarde : “**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë**”, nuk ka asnjë vlerë të shtuar, për sa kohë gjithashtu të gjitha vendimet e Komisionerit përmbajnë të njëjtën formulë “*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*”. **Po të ishte kështu, edhe vendimet e Komisionerit do të zbatoheshin pa pritur ankimit në KAS apo Kolegji.** Formula sipas të cilës vendimi “hyn në fuqi menjëherë” në rastin konkret ka rëndësi thjesht për llogaritjen e pikënisjes së afatit të ankimit, i cili sipas rastit është 3-ditë nga data e vendimit për vendimet e Komisionerit dhe 5-ditë për ankimit në Kolegji ndaj vendimeve të KAS.

Pra, të pretendosh se formula “hyn në fuqi menjëherë” i jep forcën e gjësë së gjykuar një vendim dhe e bën të ekzekutueshëm një vendim të caktuar, kur as ligji por as vetë vendimi nuk e parashikon këtë gjë,



nuk qëndron në mendimin tonë. Sipas Kodit Zgjedhor, vetëm vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë të formës së prerë. Nëse heqim një paralele me vendimet gjyqësore, është e njohur se vendimet e Apelit janë ato që janë të formës së prerë (përjashtim bën vetëm rasti kur vendimi priset për rigjykim). Rrjedhimisht, KSHZ nuk kishte asnjë detyrim të zbatonte vendimin e KAS objekt ankimi, pa pritur zgjedhjen e konfliktit midis palëve në themel nga Kolegji Zgjedhor, instanca e fundit të cilës legjislatori i ka dhënë shprehimisht mundësinë të gjykojë në themel çështjet dhe pretendimet lidhur me zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë.

Pra përfundimisht, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në gjykimin tonë ka shkelur Kushtetutën (Neni 4, pika 1 e vijues) si dhe Kodin Zgjedhor, duke vendosur regjistrimin e PD përfaqësuar nga nënkryetari me autorizim Alibeaj, si subjekt zgjedhor, pa pritur vendimin përfundimtar të Kolegjit Zgjedhor.

Nisur nga sa më sipër, KAS duhet të ndryshojë vendimin objekt ankimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke e detyruar KQZ që të pezullojë regjistrimin e Partisë Demokratike me Kryetar nënkryetarin e komanduar Alibeaj, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të 14 majit 2023, deri sa Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha.

Përfundimisht, bazuar mbi sa u argumentua më lart, Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha,

Kërkon:

1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. ____, datë 18.3.2023; dhe
2. Ndryshimin e këtij vendimi, duke vendosur: Pezullimin e regjistrimit të subjektit "Partia Demokratike" me nënkryetar z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023, deri kur Kolegji Zgjedhor të jetë shprehur me vendim përfundimtar për ankimimin e subjektit "Partia Demokratike e Shqipërisë" e përfaqësuar nga Kryetari z. Sali Berisha.

PROVAT QË PARAQITEN DHE / OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.

1. Vendimi i datës 18.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Vendimi nr. 27, datë 16.03.2023 i KAS;
3. Prova e depozitimit në Kolegj Zgjedhor të ankimit të Partisë Demokratike me Kryetar, z. Sali Berisha, ndaj vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të KAS.

Për Subjektin "Partia Demokratike e Shqipërisë" – "PD"

Kryetari Sali Berisha



Tiranë, 20/03/2023



U depozitua në sekretari
dt: 20.03.2023

ora 14 39



Partia
Demokratike



KËRKESË PADI

U pagua taksa

Tiranë, 20/03/2023 3000L

PADITËS:

Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Kryetari Z. Sali BERISHA, me adresë: Bulevardi "Zhan d'Ark" Nr.11, 1001, Tiranë.

IPADITUR:

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve – KQZ, me adresë: Rr. "Ibrahim Rugova", nr. 4, 1001, Tiranë.

KUNDËR:

Vendimit nr. 27, datë 16.03.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, i cili ka vendosur:

"1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 33 të ankuesit "Partia Demokratike", përfaqësuar në seancë nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri;

2. Pranimin e pjeshëm të kërkesës ankimore nr. 32 të ankuesit "Partia Demokratike", përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa;

3. Ankuesi "Partia Demokratike", përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa të depozitojë në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë:

- Deklaratën sipas shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

- "Deklaratën e angazhimit solemn" të nënshkruar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

4. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor "Partia Demokratike" me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij."



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve

Data: 16.03.2023

Nr: 27

Ora: 12:00

VENDIM

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE ANKIMORE NR. 32, DATË 14.03.2023 DHE NR. 33,
DATË 15.03.2023”

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 16.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES 1: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa;

KËRKUES 2: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franc Nuri

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 172, datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” dhe



- Regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023 të Partisë Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga z. Indrit Sefa
- Regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14 maj 2023 të Partisë Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, pika 1, shkronja “b”; 123/1; 124, 133-136 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Partia Demokratike e Shqipërisë, nëpërmjet z. Indrit Sefa, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për regjistrimin e Partisë Demokratike me nr. 1337 Prot, datë 6.3.2023 nga zoti Indrit Sefa, përfaqësues i kësaj partie në KQZ, i autorizuar për paraqitjen e kërkesës nga kryetari Lulzim Basha. Autorizimi mban datën 18 mars 2022.
3. Z. Sali Berisha ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr.1329 prot, datë 5.3.2023, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen në datën 14 maj 2023.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me anë të vendimit nr. 172, datë 14.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së ‘Partisë Demokratike’ për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, vendosi mosregjistrimin si subjekt zgjedhor “Partinë Demokratike” me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat nistore “PD” ose “PDSH” me arsyetimin se akti autorizues për personin që ka paraqitur kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike, ashtu edhe Deklarata e Angazhimit Solemn e kryetarit të Partisë Demokratike z. Lulzim Basha nuk përmbushin kërkesat e nenit 64 të Kodit Zgjedhor.
5. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa. Në këtë kërkesë parashtron:

- Në vendimin nr. 172, datë 14.03.2023 nuk saktësohet qartësisht se cili dokumentacion i mungon kërkesës për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor, që nevojitet të plotësohet;
- Në përputhje me rregullat e brendshme të funksionimit të Partisë Demokratike, konkretisht neni 46 i Statutit të PDSH, është lëshuar Autorizimi i Përgjithshëm datë 18 mars 2022, që përcakton se Nënkryetari i zgjedhur nga Këshilli Kombëtar i PD, z. Enkelejd Alibeaj, është komanduar të drejtojë Partinë deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri. Në këtë kuptim, nënshkrimi prej tij i deklaratës së angazhimit solemn është tërësisht i vlefshëm për tu konsideruar si marrje përsipër e përgjegjësive formale, në emër dhe për llogari të Partisë Demokratike;
- Formulimi i përmendur në autorizim *“për regjistrimin në zgjedhjet e përgjithshme vendore të vitit 2023, sipas datës së caktuar me Dekret të Presidentit të Republikës”*, ka ekzaktësisht të njëjtin kuptim me formulimin *“për regjistrimin në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të 14 maj 2023”*;
- Ndryshe nga sa shprehet Komisioneri, nga përmbajtja e nenit 64, pika 2, shkronja “e” e Kodit Zgjedhor, nuk është shprehur asnjë ndalim mbi delegimin e aktit të Deklaratës së angazhimit solemn që është nënshkruar nga z. Alibeaj; nuk rezulton që akti të jetë një akt individual i personit dhe akt ekskluziv, për shkak të përgjegjësisë në rast mospërbushje. Deklarata e bërë në emër të organit që përfaqëson partinë ndaj të tretëve, rast në të cilin përfshihet edhe KQZ, është një akt i delegueshëm, pasi nuk lidhet me cilësi apo përgjegjësi personale të individit, personit fizik që ushtron detyrën e organit të Kryetarit të Partisë. Deklarata është një akt deklarativ, sikurse konstatohet nga emërtimi, e cila nuk prodhon asnjë përgjegjësi ligjore qoftë kjo edhe personale. Përgjegjësitë ligjore nuk burojnë nga aktet deklarative por nga ligji;
- Partia Demokratike e Shqipërisë i ka përmbushur të gjitha kërkesat ligjore lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga KQZ.

6. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga s. Sali Berisha. Në këtë kërkesë parashtrohet:

- Kuvendi i Partisë Demokratike të Shqipërisë i datës 11.12.2021 si dhe Statuti i PDSH dhe organet e partisë që burojnë prej tij janë aktet e fundit ligjore në fuqi, të regjistrueshme në Regjistrin e Partive Politike, sipas dispozitave të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”;
 - Vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka certifikuar Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021, është ende në fuqi i pashfuqizuar;
 - Vendimi nr. 44, datë 03.03.2023 i Gjykatës së Apelit është një vendim jo përfundimtar dhe jo i formës së prerë i cili do të rekursohet nga ana jonë;
 - Rekordet e organeve drejtuese të Partisë Demokratike të Shqipërisë që figurojnë të pasqyruara në Regjistrin e Partive Politike janë të vjetra dhe nuk pasqyrojnë korrektësisht organet drejtuese të saj, veçanërisht për sa i përket ish-kryetarit të partisë z. Lulzim Basha;
 - Kërkesa për regjistrim e subjektit zgjedhor në zgjedhje janë akte ekskluzive të cilat i takojnë Kryetarit të Partisë dhe nuk mund të delegohen tek asnjë tjetër. Dorëheqja e Lulzim Bashës është fakt i njohur botërisht;
 - Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar Sali Berisha i ka përmbushur të gjitha kërkesat ligjore për regjistrimin e saj si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023.
7. KAS-i në datën 15.03.2023 me vendimin nr. 26 vendosi bashkimin e kërkesave ankimore nr. 32 dhe nr. 33, me relator z. Koli Bele.
8. Seanca e datës 16.03.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit, specialistëve të administratës së KQZ-së, si dhe palëve ankuese me përfaqësuesit z. Indrit Sefa, z. Ledio Nuraj dhe z. Franc Nuri.
9. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
- Vendimin nr. 172, datë 14.03.2023 “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”;
 - Kërkesën ankimore nr. 32, datë 14.03.2023;
 - Kërkesën ankimore nr. 33, datë 15.03.2023;

- Vendimin nr. 2, datë 18.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Depozitim Aktesh”;
- Vendimin nr. Regj. Them. 508, datë 22.04.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Disponim Ankimi”;
- Vendimin nr. 10, datë 13.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për depozitim në regjistrin e partive politike;
- Shkresën “Vërtetim” nr. 2148 Prot., datë 15.03.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë;
- Statutin e Partisë Demokratike;
- Kërkesën për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, nr. 27 Prot., datë 5 mars 2023 e Partisë Demokratike të Shqipërisë, prot. Nr. 1337, datë 06.03.2023; dhe
- Kërkesën për Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, me nr.1329 prot, datë 5.3.2023.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi:

1. Rregullat e Kodit Zgjedhor për regjistrimin e subjekteve zgjedhore kanë qëllim të garantojnë konkurrueshmërinë në zgjedhje, duke siguruar barazinë në garë midis partive politike, koalicioneve dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit. Kjo do të thotë se **qëllimi i rregullave nuk është në asnjë rast përjashtimi, por përfshirja dhe lehtësimi i kushteve për garë**. Kodi ka përpunuar vetëm një kriter selektiv për pjesëmarrjen në garën zgjedhore: rishtarët duhet të kapërcejnë provën e mbështetjes (listat me nënshkrimet mbështetëse nga zgjedhësit) përpara se të kërkojnë regjistrimin, kurse subjektet me historik gare mjafton të dëshmojnë suksesin e kësaj historie, duke depozituar vërtetimin se disponojnë mandat përfaqësimi nga zgjedhjet pararendëse.
2. Të gjitha kërkesat e tjera për regjistrimin kanë lidhje me deklarin e vullnetit të subjektit. Plotësimi i deklaratave kërkohet me qëllim që të sigurohet rregullshmëria e procesit zgjedhor dhe lehtësimi i mundësive për komunikim, mbikëqyrje, monitorim dhe llogaridhënie. **Kërkesat**

për deklarata shoqëruese nuk formojnë në asnjë rast kusht për përjashtimin e subjektit nga zgjedhjet.

3. Neni 64 i Kodit Zgjedhor ka përfshirë në listën e kërkesave dhe vërtetimin që partia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (shkronja "a" e pikës 2). Ky dokument shërben për të identifikuar subjektin dhe për të provuar se subjekti kërkues ka personalitet juridik, për pasojë ka zotësinë për të vepruar, për pasojë legjitimohet në të drejtën për të kërkuar regjistrimin në zgjedhje. Ky dokument është një akt zyrtar, i nxjerrë nga një regjistër zyrtar (Regjistri i Partive Politike që administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë), i cili merret dhe disponohet nga subjekti, por subjekti nuk ka asnjë mundësi të modifikojë sipas dëshirës përmbajtjen e tij.
4. Administrimi nga KQZ-ja i vërtetimit të paraqitur në zbatim të shkronjës "a" të nenit 64 të Kodit Zgjedhor ka vlerë vetëm për të identifikuar subjektin kërkues dhe për të verifikuar nëse ai ka zotësi për të vepruar. Cilësinë e të qenit parti politike nuk mund t'a pretendojë çdo grupim personash. Që të mund të konkurrosh si parti politike duhet më parë të ekzistosh ligjërisht si e tillë. Sigurinë për këtë status e jep pikërisht ky dokument. Vërtetimi i depozituar në KQZ nga ana e ankuesit të përfaqësuar nga z. Indrit Sefa provon faktin që ankuesi është i regjistruar në regjistrin e partive politike që nga data 19.12.1990. Kjo do të thote se ankuesi i përfaqësuar nga z. Indrit Sefa e ka plotësuar kërkesën e shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 64. Ankuesi i përfaqësuar nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri nuk ka disponuar për plotësimin e kësaj kërkesë duke mos depozituar asnjë vërtetim.
5. Vërtetimi i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor përmban një numër të dhënash identifikuese, të dhënat për aktin me të cilin është miratuar krijimi i partisë, emrin e partisë, shkronjat nistore të saj dhe emrin e kryetarit të partisë. Për ankuesin e përfaqësuar nga z. Indrit Sefa këto të dhëna janë: krijimi i partisë është miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 12, datë 19.12.1990, emri i partisë është "Partia Demokratike", shkronjat nistore janë "PD" ose PDSH" dhe kryetari i partisë është z. Lulzim Basha.
6. Neni 64 i Kodit Zgjedhor, përveç vërtetimit, kërkon që partia politike që kërkon regjistrimin si subjekt zgjedhor të deklarojë vetë, pavarësisht vërtetimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, emrin zyrtar, shkronjat nistore

dhe adresën e partisë dhe specimenin e vulës së partisë. Kërkesa e Kodit që subjekti të deklarojë këtë grup të dhënash, vetë dhe pavarësisht përmbajtjes që rezulton për to nga vërtetimi sipas shkronjës "a" e pikës 2 të nenit 64 të Kodit, nuk formon tepri (redundancë).

7. Për efekt të regjistrimit në zgjedhje, të dhënat identifikuese janë ato që deklaron subjekti. Nëse midis tyre dhe të dhënave që përmban vërtetimi gjyqësor ka mospërputhje, atëherë KQZ-ja është e detyruar të hetojë se mos këto mospërputhje vijnë për shkak se ndodhemi përpara një subjekti me identitet tjetër, të ndryshëm nga ai që figuron i regjistruar në gjykatë, apo subjekti është i njejtë dhe të dhënat e vërtetimit gjyqësor janë të paazhornuara. Për të dhëna të paazhornuara, KQZ-ja nuk mund të vendosë përjashtimin e subjektit nga zgjedhjet. Hetimi administrativ i Komisionerit në rastin e ankuesit të përfaqësuar nga z. Indrit Sefa provoi se mbajtja në regjistër e emrit të z. Lulzim Basha si kryetar i Partisë, kur ai ka dhënë dorëheqjen dhe është zëvendësuar në detyrë nga z. Enkelejd Alibeaj, përbën mosazhornim të regjistrit dhe jo provë se në fakt kryetar i partisë vazhdon të jetë z. Basha.
8. Kur identiteti i subjektit të regjistruar në gjykatë është i ndryshëm nga ai i subjektit kërkues, atëherë KQZ-ja është e detyruar të saktësojë identitetin, përpara se të procedojë me pranimin ose rrëzimin e kërkesës. Kërkesa e paraqitur nga një subjekt impostor duhet të rrëzohet, kurse midis dy kërkesave konkurruese që paraqiten në emër të të njejtit subjekt, KQZ-ja duhet të pranojë për shqyrtim kërkesën që demonstroi tek vetja vazhdimësinë dhe vullnetin e subjektit. Ky vërtetim kërkon, hetim dhe arsyetim juridik mbi provat. Vërtetimi nga regjistri i partive është fillesë e hetimit, jo "prova mbretëreshë".
9. Ankuesi i përfaqësuar nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri provoi me dokumentacionin dhe parashtrimet që paraqiti, se nuk e demonstroi dot vazhdimësinë e subjektit. Lëvizja e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit të PDSH-së nisi dhe u zhvillua si lëvizje kundër establishmentit të Partisë, e cila synonte ndër të tjera shkarkimin para kohe të Kryetarit të Partisë. Proceset zgjedhore të iniciuara prej saj nuk janë njohur nga pjesa tjetër e partisë dhe janë kontestuar në rrugë statutores dhe ligjore. Aktet e forumeve të mbledhura nuk janë regjistruar dot në regjistrin e partive politike dhe konflikti është duke u zhvilluar brenda sistemit gjyqësor. Deri në momentin e shqyrtimit të ankesës, ankuesi i përfaqësuar nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri nuk ka regjistruar në regjistrin e partive politike asnjë nga aktet e miratuara nga forumet e tij. Ndryshe nga ankuesi tjetër që përfaqësohet nga z. Indrit Sefa, ky

ankues nuk ndodhet në situatën e mosazhornimit të të dhënave në regjistrin e partive politike. Ai ndodhet në situatën e pamundësisë për akses në të dhënat e regjistrit për Partinë Demokratike, sepse nuk disponon mbi vendime gjyqësore që lejohet të regjistrohen dhe që mund t'i japin aksesin mbi të dhënat e Partisë. I pyetur nga KAS-i për këtë çështje, përfaqësuesi në seancë i ankuesit z. Ledio Nuraj pranoi se grupimi i tij nuk ka mundësi të regjistrojnë në regjistrin e partive politike asnjë nga aktet e miratuara nga ky grupim që nga data 11.12.2022 e deri në ditën e shqyrtimit të ankesës në KAS.

10. Mungesa e regjistrimit të akteve në regjistrin e partive politike i heq të drejtën këtij ankuesi që të identifikohet ligjërisht me Partinë Demokratike, për pasojë nuk e legjitimon për të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Komisioneri e ka konstatuar me të drejtë këtë fakt, por nuk ka disponuar me vendim për rrëzimin e kërkesës, gjë që cënon të drejtat procedurale të këtij ankuesi.

11. Ligji nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar" parashikon në nenin 14 se *"dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj te vlefshme per ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme"*. Por ky ligj nuk ka asnjë penalitet për mosazhornimin e të dhënave në regjistër. As Kodi Zgjedhor nuk parashikon mosregjistrim për mosazhornim të të dhënave. Në seancë u sollën prova se ndryshimet statutoare në periudhën para zgjedhjeve parlamentare nuk ishin azhornuar që nga prilli i vitit 2018. Nisur nga ky fakt bëhet e paevitueshme pyetja: si ka marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2021 Partia Demokratike, kur të dhënat i paska pasur të paazhornuara?! Ky fakt demonstion mjaftueshëm, se vërtetimi nga regjistri i partive është provë relative dhe duhet të vlerësohet vetëm në kontekst dhe në harmoni me provat e tjera. Ai demonstion, gjithashtu, se mungesa e azhornimit në regjistër nuk ka penalizuar subjektet asnjë herë më parë, përveçse me vendimin e Komisionerit nr. 172, datë 14.03.2023.

12. Dokumentacioni deklarativ që shoqëron kërkesën për regjistrim të ankuesit të përfaqësuar nga z. Indrit Sefa jep këtë informacion:

- Emri zyrtar i partisë është "Partia Demokratike";
- shkronjat nistore janë "PD";
- Kryetari i partisë është z. Lulzim Basha;

- adresa është “Bulevardi Zhan D’ark”, Nr. 11, Tiranë;
- specimeni i vulës është sikurse është stampuar në shkresë;
- Financieri i partisë është z. Ilir Dervishi;
- personi përgjegjës për komunikimin me KQZ-në është z. Indrit Sefa.

13. Nga dokumentacioni shoqërues i kërkesës për regjistrim të të njejtit ankues rezulton se “Deklarata e Angazhimit Solemn e Kryetarit të Partisë” është nënshkruar nga “Kryetari i Partisë me Autorizim” (*sic*), z. Enkelejd Alibeaj. Për këtë shkak, dokumentacionit i është bashkëlidhur një dokument shtesë, i pakërkuar nga neni 64 i Kodit Zgjedhor, me titullin “Autorizim i përgjithshëm”, i cili është nënshkruar nga Kryetari i Partisë z. Lulzim Basha.

14. Nga dokumentacioni shtesë i paraqitur gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës përfshihet shkresa nr. 27/3, prot., datë 14.03.2023 e z. Indrit Sefa, Sekretar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore i PD, protokolluar në KQZ me nr.1650, datë 14.03.2023. Ky dokument rikonfirmon informacionin se Kryetari i Partisë Demokratike, z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen nga funksioni më datë 21 mars 2022 dhe kumton se *“nënkryetari i zgjedhur nga Këshilli Kombëtar dhe që ishte ishte i vetmi në detyrë për këtë përgjegjësi, z. Enkelejd Alibeaj, është komanduar të drejtojë Partinë deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri”*.

15. Drejtimi i partisë politike kryhet sipas rregullave statutores të partisë, të cilat zbatohen dhe mbikëqyren nga anëtarësia e partisë dhe/ose instancat kompetente statutores të saj. Kryetari i partisë i ushtron funksionet nga momenti i zgjedhjes së tij në krye të saj, pavarësisht nga momenti kur ky akt regjistrohet në gjykatë. Ai e përfaqëson partinë në marrëdhëniet me të tretët pa pasur nevojë (pa prituri) që të kryejë më parë regjistrimin e faktit në gjykatë.

16. KAS-i është në dijeni të faktit se legjitimiteti i nënkryetarit, z. Enkelejd Alibeaj si kryetar i komanduar i Partisë Demokratike është kontestuar publikisht nga formacioni rival brenda Partisë Demokratike. Por kontestimi i zgjedhjes në detyrë të kryetarit, apo i caktimit të kryetarit të komanduar bëhet gjithashtu sipas rregullave statutores dhe shqyrtohet nga instancat kompetente statutores. Të tretët nuk kanë asnjë zë në këtë kapitull dhe nuk mund të zgjedhin t’u njohin apo të mos t’u njohin kryetarin e zgjedhur apo të komanduar të partisë. Në dijeninë e KAS-it nuk ka asnjë procedurë kontestimi statutor për drejtimin e Partisë Demokratike nga z. Enkelejd Alibeaj, as ndonjë procedurë kontestimi gjyqësor. Kjo do të thotë

se nuk ka asnjë shkak ligjor për KQZ-në për të dyshuar në vazhdimësinë institucionale nga ish kryetari Basha tek kryetari i komanduar Alibeaj.

17. Vazhdimësia institucionale nga Kryetari Basha tek kryetari i komanduar Alibeaj provohet nga autorizimi i përgjithshëm i lëshuar nga Kryetari i PD-së z. Lulzim Basha më datë 18.03.2022, kur ishte në ushtrim të plotë të tagrave të veta, sikurse provohet nga shkresa e Sekretarit të PD për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore me nr. 27/3 prot., datë 14.03.2023, protokolluar në KQZ me nr.1650 prot., datë 14.03.2023, nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.508 Regj.Them., datë 22.04.2022, si dhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nr.44, datë 03.03.2023.
18. Prandaj Kryetari i komanduar i Partisë Demokratike z. Enkelejd Alibeaj ka tagra të plota të nënshkruajë, me këtë cilësi, kërkesën për regjistrim dhe gjithë dokumentacionin deklarativ që kërkon pika 2 e nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Ky dokumentacion duhet të jetë i azhornuar, pavarësisht se regjistri gjyqësor mund të mos jetë i tillë. Autorizimi i përgjithshëm i lëshuar nga z. Lulzim Basha e ka humbur fuqinë nga momenti që ai ka dhënë dorëheqjen dhe është zëvendësuar në detyrë nga Kryetari i komanduar i Partisë, z. Enkelejd Alibeaj dhe është i panevojshëm për procedurën e regjistrimit të Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor.
19. Kërkesat e nenit 64 kërkojnë që partia politike të deklarojë informacionin aktual, jo atë që ka qenë para disa vitesh. Kjo i shërben jo vetëm rregullshmërisë së procesit të regjistrimit, por edhe nevojës për të ruajtur qartësinë e zgjedhësve dhe për të mos shkaktuar çoroditje midis tyre. Nëse Partia Demokratike drejtohet prej një viti nga z. Enkelejd Alibeaj, për shkak se kryetari i zgjedhur ka dhënë dorëheqjen, atëherë Komisioneri nuk mund të pretendojë se Partia Demokratike drejtohet ligjërisht nga kryetari i dorëhequr, sepse kjo konfondon elektoratin e kësaj partie dhe do sillte pasqyrimin në fletën e votimit të një fakti të pavërtetë, që nuk përputhet me realitetin.
20. Qëndrimi i mbajtur nga Komisioneri se përgjegjësia e nënshkrimit të deklaratës nga nënkryetari është e patransferueshme duke e krahasuar me deklarin e dëshmitarit, apo betimin e Presidentit, janë analogji të pasakta dhe vlerësim i gabuar i ligjit. Po ashtu është kontradiktor arsyetimi vijues ku Komisioneri shprehet se *“Ajo mund të nënshkruhet edhe nga nënkryetari i partisë, por kjo mund të ndodhë vetëm në kushtet kur kryetari i partisë nuk është në detyrë.*

Është rasti kur ai ka dhënë dorëheqjen, apo ka ndërruar jetë, apo nuk mundet të ushtrojë funksionet e kryetarit për arsye objektive, etj. Në këtë rast do të duhet që organet e tjera të partisë të depozitojnë në gjykatë njoftimet dhe kërkesat përkatëse sipas të cilave kërkohet që funksionet e kryetarit t'i marrë personi, apo organi që sipas statutit të partisë e ka këtë të drejtë”.

Mënyra sesi partitë politike zgjedhin të delegojnë tagrin e drejtimit të partisë tek një ose me shumë individë, në rastet kur drejtuesi i subjektit jep dorëheqjen apo ndërron jete, nuk lidhet domosdoshmërisht me depozitim në gjykatë, pasi kjo është një procedurë që ligji e zgjedhor nuk e parashikon dhe për më tepër, rregullimi i brendshëm i partive politike nuk mund të përcaktohet nga KQZ apo organet e tjera shtetërore. Në çdo rast subjekti zgjedhor nuk mund të pengohet të marrë pjesë në zgjedhje, sa kohë që personi që ushtron detyrën e Kryetarit pranon të përmbushë këtë detyrimet formale të rregjistrimit, përfshi edhe Deklaratën Solemne të vendosur me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, si një akt deklarativ i vullnetit të mirë për të zbatuar ligjin.

21. Për këto arsye KAS-i çmon se Partia Demokratike duhet të plotësojë dokumentacionin që kërkon pika 2 e nenit 64 të Kodit Zgjedhor me informacionin aktual të saj dhe jo me informacion nga historiku dhe se ajo duhet të regjistrohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, mbështetur në të dhënat e këtij informacioni. PD duhet të deklarojë në dokumentacionin shoqërues të kërkesës se për efekt të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, në cilësinë e kryetarit të komanduar të saj, është nënkryetari, z. Enkelejd Alibeaj, për rrjedhojë deklarata e angazhimit solemn duhet të plotësohet nga nënkryetari z. Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë (pa shënimin “me autorizim”), sikurse duhet të deklarohet adresa e saktë aktuale e Partisë, aty ku ushtrohet realisht veprimtaria dhe ku mund të kontaktohet realisht lidershipi i kësaj partie.
22. Ky vlerësim i KAS-it e çon ankuesin e përfaqësuar nga z. Indrit Sefa drejt korigjimit/plotësimit të deklaratave shoqëruese të kërkesës, por ndryshe nga Komisioneri, jo me imponim, por me kërkesën korrekte për të aktualizuar dokumentacionin me realitetin politik të Partisë. Ky korigjim/plotësim duhet të ndodhë përpara regjistrimit.
23. Komisioneri ka vendosur me vendimin nr. 172, datë 14.03.2023 mosregjistrimin e ankuesit si subjekt zgjedhor, për shkakun se “deklarata e angazhimit solemn” nuk është nënshkruar nga

Kryetari i partisë z. Lulzim Basha. Komisioneri e ka konsideruar këtë angazhim si angazhim personal dhe të patransferueshëm të kryetarit të partisë, prandaj nënshkrimi duhet të bëhet vetëm prej tij. Komisioneri ka injoruar në mënyrë të përsëritur faktin se z. Lulzim Basha nuk është më Kryetar i Partisë Demokratike dhe, për pasojë, nuk mund të marrë më përsipër angazhime në emër të saj.

24. KAS-i çmon se “deklarata e angazhimit solemn” është një akt që kryhet në emër të partisë politike nga niveli më i lartë drejtues i saj. KAS-i konstaton se ankuesi e ka shprehur në mënyrë të përsëritur vullnetin për ta ndërmarrë këtë angazhim solemn, përtej faktit që ka bërë depozitimin përkatës nga niveli më i lartë drejtues i tij. Insistimi që këtë deklaratë duhet ta nënshkruajë ish kryetari, për shkak se emri i tij figuron në vërtetimin nga regjistri i partive politike është pa bazë dhe as justifikim ligjor, pasojë e leximit të gabuar të shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

PËR KETO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 143, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në emër të KQZ-së, KAS-i

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 33 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Ledio Nuraj dhe z. Franci Nuri;
2. Pranimin e pjeshëm të kërkesës ankimore nr. 32 të ankuesit “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa;
3. Ankuesi “Partia Demokratike”, përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa të depozitojë në KQZ dokumentacionin shtesë si më poshtë:
 - deklaratën sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 64 të Kodit Zgjedhor me të dhënat për nënkryetarin z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;

- "deklaratën e angazhimit solemn" të nënshkruar nga nënkryetari z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
- 4. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe detyrimin e Komisionerit të regjistrojë subjektin zgjedhor "Partia Demokratike" me nënkryetarin, z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e kryetarit të komanduar të Partisë;
- 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Koli BELE - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar (Kundër)**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**



MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 32 të paraqitur nga Partia Demokratike përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa me objekt *“Kundërshtimin e vendimit nr. 172, datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”*, dhe Kërkesës Ankimore nr. 33 të paraqitur nga Partia Demokratike përfaqësuar në seancë nga z. Ledion Nuraj dhe z. Franci Nuri me objekt *“Kundërshtimin e vendimit nr. 172, datë 14.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”*, unë anëtari në pakicë, duke mos qenë dakord me argumentet dhe konkluzionet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) parashtroj argumentet e mija për zgjidhjen e çështjes si më poshtë:

1. Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje në seancë publike u provua nëpërmjet provave shkresore të administruara se, në kundërshtim me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 *“Për partitë politike”*, i ndryshuar, konkretisht me nenin 14 të tij i cili parashikon se *“dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme”*, PD e përfaqësuar në këtë procedim nga z. Indrit Sefa nuk ka regjistruar dhe azhornuar të dhënat në regjistrin e partive politike i cili administrohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë që nga prilli i vitit 2018. Nisur nga ky fakt në regjistrin e partive politike figuron ende i regjistruar si kryetar i PD z. Lulzim Basha, i cili, sikurse është fakt i ditur botërisht, ka dhënë dorëheqjen nga ky funksion në datë 21 mars 2022.
2. Përfaqësuesi z. Indrit Sefa, i pyetur në seancë për arsyet se përse nuk janë bërë azhurnimet e nevojshme në regjistër, si edhe nëse ka një afat se kur do të bëheshin këto azhurnime, në mënyrë që të evitohet mundësia eventuale e pasqyrimit të një informacioni të pasaktë në fletën e votimit, dështoi të jepte një përgjigje të saktë dhe shteruese.
3. Përfaqësuesi z. Indrit Sefa, në seancë publike përpara KAS, pranoi se PD me kryetar z. Lulzim Basha aktualisht drejtohet nga njëri nga katër nënkryetarët e saj dhe konkretisht z. Enkelejd Alibeaj i pajisur me autorizim të përgjithshëm nga kryetari për regjistrimin e partisë në zgjedhjet vendore 2023. Po sipas përfaqësuesit, z. Enkelejd Alibeaj është komanduar në detyrën e kryetarit të PD nga Sekretari i Përgjithëm i asaj partie, menjëherë pas dorëheqjes së z. Lulzim Basha. Për këtë komandim nuk u paraqit në cilësinë e provës përpara KAS asnjë akt shkresor.



4. Përfaqësuesi z. Indrit Sefa, në të njëjtën seancë publike përpara KAS, pranoi gjithashtu se në komandimin në detyrën e kryetarit të PD të z. Enkelejd Alibeaj nuk është ndjekur procedura e përcaktuar nga pika 4, e nenit 46, të Statutit të PD në fuqi në atë kohë. Konkretisht sipas statutit parashikohet se: *“Kryetari i Partisë gjatë veprimtarisë së tij të përditshme i cakton detyra dhe fusha të caktuara përgjegjësie Nënkyetarëve të Partisë. Në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi, duke përfshirë rastet e dorëheqjes nga detyra të Kryetarit, Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar, i cili komandon Nënkyetarin që do të drejtojë Partinë deri në rikthimin e Kryetarit në detyrë apo zgjedhjen e Kryetarit të ri.”.*
5. Në këtë këndvështrim, unë anëtari në pakicë i KAS, vlerësoj se procedura dhe akti i komandimit të z. Enkelejd Alibeaj (gjithmonë nëse egziston një i tillë) është një veprim i pavlefshëm, pra “nul” që nga fillimi, pasi është marrë në kundërshtim flagrant me një dispozitë urdhëruese të Statutit në fuqi të PD, i cili ishte edhe “ligji i zbatueshëm” për funksionimin e brendshëm të asaj partie. Në interpretim të pikës 4, të nenit 46 të Statutit, nënkryetari i PD autorizohet të zëvendësojë kryetarin vetëm në raste mungesash të përkohshme të kryetarit, ndërsa në rastin e dorëheqjes dispozita urdhëron që nënkryetari të komandohet në detyrën e kryetarit vetëm dhe ekskluzivisht nga Këshilli Kombëtar i PD. Si i tillë Autorizimi i Përgjithshëm i paraqitur nga subjekti pretendues për t’u regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor, është absolutisht i pavlefshëm dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Në këtë linjë edhe “akti i komandimit” të nënkryetarit z. Enkelejd Alibeaj në detyrën e kryetarit të PD nga sekretari i përgjithshëm i saj është gjithashtu i pavlefshëm dhe nuk ka krijuar asnjë pasojë juridike. Për rrjedhojë z. Enkelejd Alibeaj nuk mund të konsiderohet ligjërisht si kryetar i komanduar i PD.
6. Anëtarët në shumicë të KAS, kanë arritur në përfundimin, sipas meje të pabazuar në ligj, se: *“...në dijeninë e KAS-it nuk ka asnjë procedurë kontestimi statutor për drejtimin e Partisë Demokratike nga z. Enkelejd Alibeaj, as ndonjë procedurë kontestimi gjyqësor. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë shkak ligjor për KQZ-në për të dyshuar në vazhdimësinë institucionale nga ish-kryetari Basha tek kryetari i komanduar Alibeaj.”,* duke e “legalizuar” në këtë mënyrë shkeljen e statutit të PD të bërë në këtë rast dhe duke marrë njëkohësisht kompetencat e organeve statutorë të PD, por edhe të gjykatës e cila, duhet të ishte ajo në fakt që do të regjistronte, sikundër ligji parashikon, ndryshimet në strukturat drejtuese të partisë politike dhe t’i

pasqyronte ato në regjistrin përkatës. Mosankimimi i vendimit të sekretarit të përgjithshëm të PD për komandimin e nënkryetarit në detyrën e kryetarit të partisë, (për më tepër kur egzistenca e tij në formë të shkruar nuk provehet) nuk e bën këtë akt të ligjshëm.

7. Konkluzioni i arritur nga anëtarët në shumicë të KAS se: *“vërtetimi nga regjistri i partive është provë relative dhe duhet të vlerësohet vetëm në kontekst dhe në harmoni me provat e tjera. Ai demonstron, gjithashtu, se mungesa e azhornimit në regjistër nuk ka penalizuar subjektet asnjë herë më parë, përveçse me vendimin e Komisionerit nr. 172, datë 14.03.2023.”*, anashkalon rolin e gjykatës dhe të regjistrit të partive politike që ajo administron. Në këtë kontekst ky argumentim mund të jetë njësoj i vlefshëm edhe për efekt të pranimit të kërkesës për regjistrim të PD me kryetar z. Sali Berisha. Në këtë rast madje, pavarësisht faktit se ende nuk është pasqyruar në regjistrin e partive politike, egziston një vendim gjyqësor (nr.3, datë 25.3.2022) i cili ka pranuar kërkesën për të depozituar dhe regjistruar disa nga vendimet e Kuvendit të PD, ndër të cilët edhe ai për zgjedhjen e kryetarit të ri të kësaj partie.
8. Anëtarët në shumicë të KAS, me anë të interpretimit të cituar më sipër duke vlerësuar se z. Enkelejd Alibeaj ka tagra të plota të nënshkruajë, me cilësinë e Kryetarit të komanduar të Partisë Demokratike, kërkesën për regjistrim dhe gjithë dokumentacionin deklarativ që kërkon pika 2, e nenit 64 të Kodit Zgjedhor, kanë dalë përtej kompetencave të dhëna KAS-it nga Kodi Zgjedhor dhe madje përtej qëndrimit dhe kërkit të vetë kërkuesit, i cili në kërkesën nr. 27, datë 05.3.2023 të paraqitur KQZ për regjistrimin e PD në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe në dokumentacionin shoqërues të saj (autorizimi dhe deklaratën), ka njohur dhe pohuar faktin se kryetari i kësaj partie është z. Lulzim Basha. I njëjti qëndrim është mbajtur nga kërkuesi edhe në Kërkesën Ankimore nr. 32, objekt i këtij shqyrtimi nga KAS.
9. Është fakt botërisht i ditur se ka një konflikt të hapur prej kohësh lidhur me përfaqësimin real të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Vendimmarrja e anëtarëve në shumicë të KAS, e cila me gjasë do të pasohet nga një vendim i KSHZ i cili do të regjistrojë në zgjedhjet e datës 14.5.2023 PD me kryetar të komanduar z. Enkelejd Alibeaj, duke përdorur të njëjtat argumente, favorizon padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin njërën palë megjithë faktin se ajo ka dështuar qëllimisht të pasqyrojë në regjistrin e partive politike ndryshimet e pretenduara në drejtimin e partisë, kundrejt palës tjetër, e cila provohet se ka qenë aktive duke respektuar

procedurat statuore dhe ligjore në pasqyrimin dhe regjistrimin e ndryshimeve në statutin dhe organet drejtuese të partisë.

10. Qendrimi i mbajtur nga Komisioneri se përgjegjësia e nënshkrimit të deklarates nga kryetari është e patransferueshme dhe se ajo mund të transferohet vetëm pasi organet e tjera të partisë të depozitojnë në gjykatë njoftimet dhe kërkesat përkatëse, sipas të cilave kërkohet që funksionet e kryetarit t'i marrë personi, apo organi që sipas statutit të partisë e ka këtë të drejtë, është një interpretim i drejtë dhe në zbatim të ligjit. Për rrjedhojë është i drejtë dhe i bazuar në ligj edhe vendimi i tij për të mos regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 PD e përfaqësuar në këtë procedim nga z. Indrit Sefa.
11. Përsa i përket Kërkesës Ankimore nr. 33, me vendimin objekt ankimi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka konstatuar se mungesa e regjistrimit të akteve në regjistrin e partive politike i heq të drejtën ankuesit PD me kryetar z. Sali Berisha që të identifikohet ligjërisht me Partinë Demokratike, për pasojë nuk e ka legjitimuar për të marrë pjesë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. As me vendimin objekt ankimi, Komisioneri nuk i ka dhënë zgjidhje në themel kërkesës, megjithëse ishte orientuar ta bënte këtë edhe nga një vendimmarrje të mëparshme e KAS. Komisioneri kishte detyrimin ligjor që të shprehet me vendim për pranimin ose rrëzimin për secilën nga kërkesat. KAS nuk mund ta bëjë këtë, pasi nuk mund të ushtrojë kompetenca të cilat nuk i janë ngarkuar shprehimisht nga ligji. Kjo do të thotë se ai nuk mund të shprehet për themelin e kërkesave, pa u shprehur më parë Komisioneri si organ kompetent për shqyrtimin dhe zgjidhjen e tyre. Në këtë kontekst, bazuar në të gjithë dokumentacionin e administruar, KAS duhet të urdhëronte Komisionerin për t'u shprehur me vendim pranimi për këtë kërkesë.
12. Pluralizmi është një nga bazat e shtetit shqiptar dhe ky i fundit ka për detyrë ta respektojë dhe ta mbrojë atë. Partitë politike dhe krijimi i tyre gëzon mbrojtje kushtetuese për vetë faktin se janë baza e pluralizmit politik në vend. Neni 9, i Kushtetutës parashikon se *"Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike."* Neni 45, pika 1, i Kushtetutës parashikon se *"Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet."* Ndërsa neni 46, i Kushtetutës, në pikat pika 1 dhe 2 të tij parashikon se *"1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. 2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i*

shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.”. Në nenin 1, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar parashikohet se “Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.”. Në nenin 3, të po këtij ligji parashikohet se “Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.”. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 32, datë 21.06.2010, ka theksuar se “... pluralizmi është një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme” dhe “Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor”. Në këtë kontekst, unë anëtar në pakicë i KAS vlerësoj se është e provuar se PD e përfaqësuar në këtë procedim nga z. Ledion Nuraj dhe z. Franci Nuri, i ka marrë të gjithë masat e duhura për ndryshimet në organizimin e saj të brendshëm në përputhje me procedurat statuore në fuqi në kohën e zhvillimit të tyre dhe më pas për regjistrimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pasqyrimi i këtyre ndryshimeve dhe regjistrimi i tyre është një çështje që varet nga faktorë jashtë vullnetit të saj. Asnjë institucion shtetëror nuk mund të çënojë pluralizmin politik dhe të drejtën e individëve për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet e qeverisjes, ndaj vendimmarrja e KAS duhet të orientohet drejt zgjidhjes për regjistrimit të kësaj partie si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Anëtar në pakicë: Elvis Çefa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.3.2023

Nr: 172

Ora: 16:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË "PARTISË DEMOKRATIKE" PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 14.3.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me palë si më poshtë:

Kërkues: Partia Demokratike e përfaqësuar nga kryetari z. Lulzim Basha

Objekti: Regjistrimi i "Partisë Demokratike" si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Neni 64, i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe pasi vlerësova dokumentacionin përkatës,

V Ë R E J:

Nga aktet dokumentare që janë paraqitur për të mbështetur kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike, rezulton se çështja e legjitimitetit për të kërkuar regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor është objekt i shqyrtimit administrativ.

Data: 14.3.2023 Nr: 172
Ora: 16:00



Për shqyrtimin e kërkesës "Partisë Demokratike", për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kërkesa për regjistrimin e Partisë Demokratike është paraqitur me nr. 1337 Prot datë 6.3.2023 nga zoti Indrit Sefa, përfaqësues i kësaj partie në KQZ, i autorizuar për paraqitjen e kërkesës nga kryetari Lulzim Basha. Autorizimi mban datën 18 mars 2022.

Z. Sali Berisha ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr.1329 prot, datë 5.3.2023, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen në datën 14 maj 2023.

Në vlerësim paraprak të këtyre dy kërkesave, bërë edhe në seancën e datës 9.3.2023 rezulton se z. Sali Berisha nuk ka legjitimitetin për të kërkuar regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Është fakt ligjor se z. Lulzim Basha është kryetar i Partisë Demokratike.

(1).

Regjistrimi dhe funksionimi i partive politike rregullohet me ligjin nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar. Sipas nenit 9 të këtij ligji "*Regjistrimi i partive politike bëhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, numri i anëtarëve themelues, shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent*".

Në kuptim të kësaj dispozite i vetmi dokument zyrtar, i cili na jep të dhëna mbi emrin e kryetarit të partisë është regjistri i partive politike i Gjykatës së Rrethit Tiranë. Kështu nga vërtetimi i datës 1 Mars 2023 i lëshuar nga Zyra e këtij Regjistri rezulton se kryetar i Partisë Demokratike është z. Lulzim Basha.

Mbi faktin ligjor se z. Lulzim Basha është kryetar i PD, konkludohet se vetëm ky i fundit ka legjitimitetin të paraqesë kërkesën për regjistrimin e kësaj partie si subjekt zgjedhor. Nuk ka asnjë pengesë ligjore që kryetari i partisë të autorizojë një person tjetër për të paraqitur këtë kërkesë.

Sikurse çdo akt tjetër përfaqësimi edhe autorizimi i kryetarit të partisë dhënë një personi tjetër për të kryer ky i fundit (në këtë rast) procedurat e regjistrimit të partisë si subjekt zgjedhor, duhet të jetë i qartë në kuptim të veprimit apo veprimeve që duhet të kryejë përfaqësuesi/i autorizuari.

Kështu sipas këtij autorizimi (datë 18 Mars 2022) z. Indrit Sefa (ai veçmas ose personat e tjerë të autorizuar në këtë akt) ka të drejtën që "lidhur me zgjedhjet vendore 2023 sipas datës së caktuar nga Dekreti i Presidentit të Republikës.....të nënshkruajë vetë ose të autorizojë persona të tretë për të nënshkruar dokumentet për regjistrimin e Partisë Demokratike (PD)..."

Në vlerësim të përmbajtjes së këtij autorizimi çmohet se atij i mungon qartësia në lidhje me tagrat që ka i autorizuari. Autorizimi nuk është qartësisht për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023. Dhe nuk është as për të gjitha zgjedhjet që mundet të zhvillohen në vitin 2023.

Nga ana tjetër në kushtet kur pretendohet se kryetari i partisë ka dhënë dorëheqjen dhe funksionet e tij i kryen nënkryetari, a është më i vlefshëm ky autorizim?

(2).

Neni 64 gërma "e" e Kodit Zgjedhor përcakton se për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike **duhet** të paraqesë në KQZ, krahas dokumenteve të tjerë edhe deklaratën **me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike** ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve, etj.

Në pamje të parë deklarata duket si nje element formal dhe jo i lidhur ngushtësisht me pranimin e kërkesës për regjistrim të një partie politike dhe vlefshmërinë e procesit të regjistrimit të partisë politike si subjekt zgjedhor. Por në fakt në kuptim të përmbajtjes të normës (nenit 64, pika 2 germa "e") nuk është kështu.

Formulimi i mësipërm i kësaj dispozite nuk lë vend për kuptime/interpretime të tjera veç atij se paraqitja e këtij dokumenti **është kusht** (duhet) për pranimin e kërkesës për regjistrim të një partie politike si subjekt zgjedhor.

Për të kuptuar rëndësinë dhe vlefshmërinë juridike të një procesi bazuar edhe në një aspekt formal të tij, sjell si shembull zgjedhjen e Presidentit të Republikës dhe aktin e betimit të tij. Presidenti i Republikës zgjidhet nga Kuvendi.

Vendimi i Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit nuk i jep atij automatikisht të drejtën për të ushtruar funksionin pa bërë betimin. Betimi është vërtet një akt formal, është një akt solemn, por mos kryerja e tij sikurse përcaktohet në Kushtetutë nuk e lejon Presidentin të fillojë ushtrimin e detyrës.

Po të njëjtën vlerë juridike në lidhje me pranimin e kërkesës për regjistrim të partisë politike si subjekt zgjedhor, mbart edhe Deklarata Solemne referuar nenit 64 pika 2 gërma "e" e Kodit Zgjedhor.

(3).

Nga ana tjetër ky dokument (Deklarata) duhet të jetë në përmbajtje dhe në formë sipas parashikimeve po të nenit 64, pika 2 gërma "e" e Kodit Zgjedhor.

Rezulton se Deklarata Solemne nuk është nënshkruar nga kryetari i partisë z. Lulzim Basha, por është nënshkruar nga nënkryetari, z. Enkeled Alibeaj.

Nënshkrimi nga nënkryetari Alibeaj është bërë në bazë të autorizimit që z. Lulzim Basha si kryetari PD ka lëshuar në datën 18 Mars 2022.

Përfaqësuesi i PD në KQZ, z. Indrit Sefa pretendon se z. Alibeaj e ka të drejtën të nënshkruajë edhe Deklaratën Solemne të angazhimit, pasi është i autorizuar nga kryetari i partisë për ta bërë këtë. Ky pretendim nuk ka bazë ligjore.

Deklarata solemne e kryetarit të partisë sipas asaj që përcakton neni 64, pika 2 gërma "e" e Kodit Zgjedhor duhet të nënshkruhet vetëm nga kryetari i partisë.

Përmbajtja e nenit 64 të Kodit Zgjedhor është shumë e qartë në lidhje me përgjegjësinë që kryetari i partisë ka për të marrë angazhimin solemn në emër të partisë për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve etj. Ky angazhim është një përgjegjësi personale e kryetarit të partisë dhe si e tillë kjo përgjegjësi nuk mund të jetë e transferueshme tek asnjë i tretë.

Karakteristika e (i) solemnitetit e deklaratës, si dhe përcaktimi se deklarata (ii) **duhet** të jetë e nënshkruar nga kryetari i partisë tregojnë qartë se ai dokument është një akt ekskluziv vetëm i kryetarit të partisë. Si solemniteti, ashtu edhe urdhërimi për nënshkrim me titullim të përcaktuar nuk mund të delegohen, përveçse nëse ligji ka përcaktuar ndryshe. E në këtë rast nuk ka një përcaktim ndryshe si nga Kodi Zgjedhor ashtu edhe nga pjesa tjetër e legjislacionit në fuqi.

Përgjegjësia vetëm e kryetarit të partisë për të bërë këtë deklaratë për analogji është e njëjtë me përgjegjësinë e një dëshmitari. Përgjegjësia e një dëshmitari në një proces gjyqësor, apo edhe administrativ nuk mund të transferohet tek të tretë. Ajo është gjithmonë dhe tërësisht një përgjegjësi personale.

Edhe solemniteti i aktit të një funksioni publik nuk mundet të transferohet. Për analogji akti solemn i betimit të Presidentit të Republikës, apo të gjyqtarit të gjykatës së lartë, apo i ministrit, etj, nuk është një akt që mundet të transferohet duke u autorizuar tek të tretë.

Nëse deklarata angazhuese e kryetarit të partisë do të lejohej të paraqitej edhe nga një person tjetër i autorizuar nga kryetari, atëhere ligjvënësi nuk do të ishte kujdesur që **ta përkufizonte** atë **si solemne**. Gjithashtu ligjvënësi nuk do të ishte kujdesur të tregonte qartë se ajo (deklarata) duhet të jetë **e nënshkruar nga vetë kryetari i partisë**.

Përndryshe formulimi i dispozitës në fjalë do të mjaftohej vetëm me një përmbajtje të tillë: "për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike **duhet** të paraqesë në KQZ:

- deklaratën **nga kryetari i partisë politike** ku përmendet angazhimi për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, etj".

Nëse formulimi do të ishte i tillë si më sipër, atëhere në këtë rast mund të kishte vend të interpretohej se Deklarata mund të nënshkruhet edhe nga një person tjetër i autorizuar nga kryetari i partisë.

Përfaqësuesi i PD në KQZ, z. Sefa pretendoi se është fakt i njohur botërisht që prej marsit 2022 z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen si kryetar i PD-së. Ndaj në këto kushte, sipas atij, nuk është e mundur që z. Basha të nënshkruajë Deklaratën Solemne.

Ky pretendim nuk ka asnjë bazë ligjore. Fakti që kryetari i partisë “nuk gjendet”, sepse ka dhënë dorëheqjen nuk përligj mos paraqitjen e Deklaratës sipas përcaktimit të ligjit.

E nga ana tjetër ky pretendim vjen në kontradiktë me veprimet/kërkimet konkrete të bëra nga të autorizuarit prej z. Lulzim Basha në kuadër të procesit të regjistrimit të PD si subjekt zgjedhor.

Kur është rasti për të legjitimuar kërkesën për regjistrim të PD si subjekt zgjedhor kundrejt pretendimit të z. Sali Berisha se është ai që ka legjitimitetin për të kërkuar regjistrimin e PD si subjekt zgjedhor, nga i autorizuari prej z. Lulzim Basha dhe përfaqësuesi i PD në KQZ z. Sefa sillet si provë fakti juridik i pasqyruar në vërtetimin e Zyrës së Regjistrimit të partive Politike i gjykatës së rrethit Tiranë sipas të cilit ligjërisht kryetar i PD është z. Lulzim Basha.

Kur u kërkohet që përderisa z. Lulzim Basha është kryetar i Partisë Demokratike dhe është ai që duhet të përmbushë të gjitha detyrimet që Kodi Zgjedhor i ngarkon atij posacërisht, atëhere sillet në vëmendje pretendimi se z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen si kryetar dhe se ky është një fakt i njohur publik. E për këtë shkak, sipas pretenduesit nuk është e mundur që atij t'i merret nënshkrimi për Deklaratën Solemne. Sipas tij (z. Sefa) nënshkrimi i saj nga i autorizuari z. Enkelejd Alibeaj është në përputhje me parashikimet e nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

Sikurse arsyetuar nënshkrimi i Deklaratës Solemne është një përgjegjësi e kryetarit të partisë e patransferueshme.

Ajo mund të nënshkruhet edhe nga nënkryetari i partisë, por kjo mund të ndodhë vetëm në kushtet kur kryetari i partisë nuk është në detyrë. Është rasti kur ai ka dhënë dorëheqjen, apo ka ndërruar jetë, apo nuk mundet të ushtrojë funksionet e kryetarit për arsye objektive, etj. Në këtë rast do të duhet që organet e tjera të partisë të depozitojnë në gjykatë njoftimet dhe kërkesat përkatëse sipas të cilave kërkohet që funksionet e kryetarit t'i marrë personi, apo organi që sipas statutit të partisë e ka këtë të drejtë.

Vendimi, apo vendimet e mundshme të organeve përkatëse të partisë sipas të cilave kompetencat e kryetarit, i kanë kaluar personit, apo organit përkatës të partisë depozitohen në regjistrin e partive.

Vetëm gjykata vlerëson legjitimitetin e ushtrimit të rolit të kryetarit nga një organ tjetër i partisë në kushtet kur kryetari për një arsye ose për një tjetër nuk është në detyrë.

Kështu edhe në rastin konkret, kryetari i PD z. Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen që prej Marsit 2022.

Për vetë kryetarin (apo ish-kryetarin e PD z. Basha) nuk ka asnjë detyrim ligjor për ta formalizuar aktin e dorëheqjes e për më tepër për ta paraqitur atë përpara ndonjë institucioni publik. Ai është i përligjur në mos interesin e tij në lidhje me administrimin ligjor të aktit të dorëheqjes.

Por organet e tjera drejtuese të partisë, si nënkryetari, apo sekretari i përgjithshëm, apo kushdo tjetër që sipas statutit mendohet se mundet të marrë funksionet e kryetarit kur ai ka dhënë dorëheqjen, apo edhe një palë tjetër e interesuar (ndoshta edhe anëtar i partisë) do të duhej të depozitonin në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Tiranë njoftimin, sipas të cilit kryetari i PD z. Basha ka dhënë dorëheqjen, si dhe aktin sipas të cilit PD drejtohet tani nga nënkryetari i saj z. Enkelejd Alibeaj.

Si ligji për partitë politike, ashtu edhe Kodi Zgjedhor, apo edhe ndonjë ligj tjetër nuk e detyrojnë një parti politike që në kushtet kur kryetari ka dhënë dorëheqjen, të zgjedhin detyrimisht kryetarin e ri. Për arsye dhe interesa të vetat, partia mund të vendosë që ajo për një kohë, sipas përcaktimeve të statutit të saj, të drejtohet dhe të përfaqësohet nga nënkryetari, apo nga ndonjë organ tjetër i partisë.

E në këtë rast ky organ ka të gjitha atributet e kryetarit dhe njihet edhe nga të tretët si i tillë, edhe pse formalisht nuk është kryetari i partisë.

Organet e tjera drejtuese të PD, pasi z. Basha dha dorëheqjen (sipas tyre) kanë patur rreth një vit kohë në dispozicion për të bërë depozitimet e akteve si më sipër përmëndur në Zyrën e Regjistrimit të partive politike në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vetëm kështu z. Alibeaj, si nënkryetar i PD do të kishte përfituar të gjitha kompetencat e kryetarit të PD duke mos qënë formalisht i tillë.

Në kushtet kur në Zyrën e Regjistrimit të partive politike të Gjykatës së Rrethit Tiranë nuk është bërë njoftimi i dorëheqjes së z. Lulzim Basha si kryetar, si dhe nuk është bërë depozitimi i aktit sipas të cilit (bazuar në statutin e PD), është z. Alibeaj ai që ushtron detyrën e kryetarit, atëhere ai si nënkryetar i PD mund të pranohet se i ushtron disa kompetenca, apo edhe pjesën më të madhe të kompetencave formale të kryetarit të PD, por nuk mund të pranohet se i ushtron të gjitha, vecanërisht përgjegjësitë e këtij të fundit.

Kjo do të thotë se në kushte ai (z. Alibeaj ne cilësinë si nënkryetar) nuk mundet të nënshkruajë Deklaratën Solemne.

Në vlerësim përfundimtar të sa më sipër arsyetuar, rezulton se si akti autorizues për personin që ka paraqitur kërkesën për regjistrim të Partisë Demokratike, ashtu edhe Deklarata e Angazhimit Solemn e kryetarit të Partisë Demokratike z. Lulzim Basha nuk përmbush kërkesat e nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, nenin 64, pika 2, gërma "e", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe nenin 9, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar.



VENDOSA:

1. Të mos regjistroj "Partinë Demokratike" me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat nistore "PD" ose "PDSH" si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

